



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Ekstrakt,

i procesverbalit të mbajtur më 23 mars 2016, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, në diskutimin publik për propozim Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës nr.01-006-17251 të datës 02 mars 2016

Takimi filloi në orën 10:10

Takimin e hapi dhe e kryesoi, z.Agron Hyseni drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në mbledhje të pranishëm ishin edhe disa drejtorë të Drejtorive të Komunës, disa këshilltarë të Kuvendit të Komunës, përfaqësues të mediave lokale, dhe zyrtarë tjerë të administratës komunale. (sipas listës së nënshkrimeve të bashkëngjitur).

- **Propozim Rregullorja për mbrojtjes e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre**

z.Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e hapi mbledhjen duke përshëndetur dhe falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, ndër të tjera theksoi, lajmërimi për këtë diskutim publik me qytetarë është bërë me kohë në mjete të informimit, në veb-faqe të Komunës duke për fshirë edhe atë të facebook dhe në tabelën e shpalljeve në hyrje të objektit të Komunës, mirëpo siç po vërehet nuk ka qytetarë të cilët kanë shpreh dëshirë për të marrë pjesë në këtë diskutim, dhe në këtë aspekt është pak sa për shqetësim numri i vogël i pjesëmarrësve në këtë diskutim,

vlen të theksohet Propozim Rregullorja përkatëse është në diskutim publik deri më 01.04.2016 dhe kushdo që ka propozime, vërejtje dhe sugjerime të ndryshme, ato mund t'i paraqet në formë të shkruar dhe në mënyrë elektronike në Zyrën e Informimit dhe në Zyrën Ligjore, dhe sigurisht se të gjitha ato propozime, vërejtje dhe sugjerime janë të mirëseardhura dhe të gjitha do të shqyrtohen dhe analizohen me kujdes ku të gjitha ato të cilat konsiderohen si të rëndësishme sigurisht se do të propozohen në Kuvendin e Komunës për miratim përkatësisht për inkorporimin e tyre në dokumentin final i cili do të propozohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

Nëse jeni të pajtimit, unë propozoj që përmes monitorit-projektorit të paraqesim draft rregulloren e cekur dhe nen për nen mund të japim propozime për plotësim ndryshime, sugjerime dhe vërejtje të ndryshme.

z.Haki Rudari, theksoi, propozoi që në nenin 3 paragrafi 1, të përfshihen edhe lokalet të cilat gjenden afër shkollave 100-200 metra. Me arsyetimi që edhe në ato lokale të ndalohet shitja dhe shërbime i pijeve alkoolike.

z.Faik Gashi, theksoi, konsideroj se nuk bënë t'ju kufizohet e drejta e shitjes të çfarëdo produkti i cili nuk kufizohet me legjislacion, lokaleve apo bizneseve të cilat gjenden afër objekteve shkollore. Ndërsa sa i përket arsyes së parafolësit i cili e propozoj një gjë të tillë, mendoj se çështja e cekur është e rregulluar me këtë dokument, përkatësisht nuk lejohet shitja dhe shërbimi me alkool për personat e mitur, si dhe nuk lejohet pirja dhe shitja e duhanit për këta persona, prandaj propozim Rregullorja përkatëse e rregullon shumë qartë këtë çështje.

z.Haki Rudari, theksoi, ne që punojmë në arsim ndoshta jemi më shumë në rrjedha sa i përket sjelljeve të nxënësve përkatësisht atyre të mitur, dhe në këtë aspekt ka informata se në shkollat e mesme të qytetit konsumohet edhe duhani nga nxënësit e atyre shkollave, prandaj mendoj se është e nevojshme të ndërmerren hapa konkret për parandalimin e këtyre dukurive përkatësisht të ndërmerren veprime konkrete në këtë aspekt dhe mos të miratojmë dokumente të tilla të cilat pastaj ndodh të mos zbatohen, por mbesin vetëm në letër.

z.Faik Gashi, theksoi, mendoj që neni 6 i propozim Rregullores sipas së cilit përcaktohen mbikëqyrësit e zbatimit të kësaj Rregulloreje, duhet të zhvendoset në renditje, përkatësisht të vihet para nenit 9 të propozim Rregullores.

z.Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për diskutim, dhe duke u bazuar në atë që diskutimi publik zgjatë deri më 01 prill 2016, inkurajoj të gjithë qytetarët të cilët kanë propozime, sugjerime apo vërejtje të ndryshme, në formë fizike por edhe në mënyrë elektronike mund t'i dorëzojnë në Zyrën e Informimit dhe në Zyrën Ligjore brenda orarit të rregullt të punës, në mënyrë që të gjitha ato të cilat konsiderohen si të arsyeshme do të paraqiten në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim ku pastaj do të inkuorohen në dokumentin final.

Është me rëndësi që dokumenti final të konsiderohet i hartuar ose përgatitur nga Komuna e Podujevës dhe Qytetarët e Komunës dhe të konsiderohet si dokument gjithëpërfshirës.

Për fund ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe për kontributin e juaj në këtë diskutim.

Takimi përfundoi në orën 10.30

Procesverbalin e mbajti:

Enis Sheholli

**Podujevë,
23 mars 2016**

z.Agron Hyseni

**Drejtor i Drejtorisë Së Shëndetësisë
dhe Mirëqenies sociale**